



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1442/3 prot.,

Datë 27.06.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

- Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Tower” SHPK në procedurën e prokurimit “*Sherbim konsulence*”, me Nr. REF-64749-04-03-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Plotësimi i punimeve të mbetura në aksin Porto Romano – Durrës Loti 3*”, me fond limit 5.798.242,13 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 16.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.
- Ankimues:** Operatori ekonomik “Tower” SHPK
Zona Kadastrale 2679, Hyrja 2, AP.39, Kashar, Mëzez, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Autoriteti Rrugor Shqiptar
Rruga “Sami Frashëri”, Nr.33, Tiranë

Në datën 26.06.2023 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3202, date 23.06.2023 dhe nr. protokoli 1442 datë 26.06.2023 e operatorit ekonomik “Tower” SHPK për procedurën e prokurimit “*Sherbim konsulence*”, me Nr. REF-64749-04-03-2023, me objekt: “*Supervizion punimesh Plotësimi i punimeve të mbetura në aksin Porto Romano – Durrës Loti 3*”, me fond limit 5.798.242,13 lekë (pa tvsh), zhvilluar me datë 16.06.2023 nga autoriteti kontraktor, Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik ankimues “Tower” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Bazuar në nenin 112, pika 4, gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon:
b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar;”.

Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik “Tower” SHPK kundërshton me anë të ankimit elektronik me nr. A/2023/3202, date 23.06.2023 dhe nr. protokolli 1442 datë 26.06.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyet e skualifikimit si më poshtë vijon:

Arsyet e skualifikimit:

Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertës së tyre duhet ti referohen VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, si dhe në mbështetje të Udhëzimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, Nr.5585 Prot “Rekomandim mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354, datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”.

Të gjitha ofertat me vlerë më të ulët se vlera minimale e lejuar dhe me vlerë më të lartë se vlera maksimale e lejuar, sipas përcaktimeve të bëra në VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, do të skualifikohen.

Operatori ekonomik duhet të respektojë legjislacionin në fuqi dhe tarifatat minimale të shërbimit të mbikëqyrjes së punimeve referuar VKM nr.354, datë 11.05.2016 “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, duke dorëzuar një ofertë të detajuar ekonomike e cila garanton Autoritetin Kontraktor në përmbushjen e termave të referencës.

Gjithashtu operatori ekonomik ankimues në ankesën e tij pretendon se:

Per sa me siper, perderisa kemi te dhena ne kundërshtim me njëra tjetren, dhe AK nuk ka bere transparence per llogaritjen e vleres minimale.

1. Kerkojme qe Autoriteti Kontraktor te publikoje procesverbalin e llogaritjes se vleres minimale dhe maksimale, duke percaktuar qarte kategorine dhe grupin tarifar te perdorur ne llogaritje, me qellim qe te sigurohemi qe si AK, si OE pjesemarrres, kane te njejtin kuptim mbi vleren minimale.

2. Kërkojme Ekspert te pavarur per perlllogaritjen e tarifave minimale dhe maksimale per sherbime ne planifikim territori, projektim, mbikeqyrje edhe kolaudim, ne perputhje me VKM nr.354 date 11.05.2016. Objekti i ekspertizes te jete llogaritja e fondit limit dhe vleres minimale te procedures objekt ankimimi.

Publikuar në regjistrin e ankesave më datë 27.06.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri